

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	26/06/2026		
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
	01-060/01-	24727	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas –Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit



PROCESVERBAL TUBIMI I PARË ME PUBLIKUN

Data	Ora	Vendi
25 qershor 2026	11:00 – 12:30	Salla e Mbledhjeve të Kuvendit Komunal

Tubimi me publikun lidhur me aktivitetet e komunës për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2026 u mbajt më 25 qershor 2026. Tubimin e hapi dhe e moderoi **Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra.**

PJESËMARRËSIT INSTITUCIONALË

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita
1	Ramiz Lladrovci	Kryetar i Komunës
2	Arben Shala	Nënkryetar i Komunës
3	Endrit Gllareva	Drejtor i Drejtorisë për Infrastrukturë Lokale
4	Petrit Gashi	Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
5	Muhamet Gjoka	Drejtor i Drejtorisë Komunale për Arsim
6	Arian Krasniqi	Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
7	Shkurije Azizi	Drejtoreshë e Drejtorisë së Inspeksionit
8	Enver Hoxha	Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
9	Alban Zogaj	Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
10	Nexhmedin Gruda	Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë



RRJEDHA E TAKIMIT

Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra, në cilësinë e moderatorit të tubimit, iu drejtua të pranishmëve duke i përshëndetur dhe informuar lidhur me qëllimin e takimit. Ai theksoi se, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimin Administrativ për Administratë të Hapur, Komuna është e obliguar të mbajë dy tubime me publikun gjatë vitit kalendarik. Gjithashtu, ai njoftoi se thirrja për këtë tubim është publikuar me kohë në ueb-faqen zyrtare të Komunës, në rrjetet sociale, në hapësirat e objektit komunal dhe në mediat online.

Më tej, moderatori i njoftoi pjesëmarrësit për rregullat e zhvillimit të takimit, duke theksuar se tubimi ka karakter informues dhe synon prezantimin e aktiviteteve, të arriturave, sfidave dhe investimeve kapitale të Komunës, si dhe ofron mundësinë që qytetarët të parashtrojnë pyetje, kërkesa dhe sugjerime lidhur me çështjet me interes publik. Në fund, ai foli Kryetarin e Komunës, Ramiz Lladrovci, për të paraqitur aktivitetet dhe projektet e realizuara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, prezantoi raportin e punës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026, duke informuar qytetarët për projektet dhe aktivitetet e realizuara në fusha të ndryshme, përfshirë infrastrukturën, arsimin, shëndetësinë, bujqësinë, shërbimet publike dhe zhvillimin ekonomik.

Kryetari Lladrovci theksoi se qëllimi i këtij raportimi është informimi i qytetarëve lidhur me punën e institucioneve komunale gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, si dhe prezantimi i projekteve dhe aktiviteteve të planifikuara për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2026.

Gjatë prezantimit, ai foli edhe për sfidat me të cilat është përballur Komuna e Drenasit, duke përmendur ndikimin e pagesave të realizuara përmes procedurave përmbareme në buxhetin komunal, të cilat kanë ndikuar në dinamikën e zbatimit të disa projekteve të planifikuara.

Pas raportimit të kryetarit, qytetarët patën mundësinë të parashtrojnë pyetje, të japin sugjerime dhe të shprehin shqetësimet e tyre lidhur me çështje të ndryshme me interes për komunitetin. Përfaqësuesit komunalë ofruan sqarimet dhe përgjigjet e nevojshme, duke zhvilluar një diskutim të hapur dhe konstruktiv.

Tubimi publik u zhvillua në frymë bashkëpunimi dhe transparence, duke reflektuar përkushtimin e Komunës së Drenasit për llogaridhënie dhe përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse, me qëllim të avancimit të mëtejshëm të zhvillimit të komunës dhe përmirësimit të shërbimeve për qytetarët.



TABELA E PYETJEVE, KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Shënim metodologjik: Vlerësimi është bërë mbi bazën e përgjigjeve të dhëna gjatë tubimit. “Pranohet” nënkupton zotim të qartë për realizim; “Pjesërisht pranohet” nënkupton trajtim, verifikim ose procedurë pa zotim të plotë; “Refuzohet” nënkupton se nuk është dhënë zotim për kërkesën, çështja është jashtë kompetencës komunale ose është ruajtur procedura ekzistuese. Ky vlerësim ka karakter redaktues dhe nuk e zëvendëson një vendim formal të organit kompetent.

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT

Pranohet	Pjesërisht pranohet	Refuzohet	Gjithsej
7 kërkesa (33.3%)	11 kërkesa (52.4%)	3 kërkesa (14.3%)	21 kërkesa

TABELA E DETAJUAR

Nr.	Parashtruesi / lokaliteti	Pyetja ose kërkesa	Përgjigjja institucionale	Vlerësimi	Arsyetimi i vlerësimit
1	Xhevdet Krasniqi Negroc dhe Vuçak	Rifillimi i punimeve në rrugën Arllat–Negroc–Vuçak.	Punimet janë ndërprerë përkohësisht për arsye teknike dhe është konfirmuar se do të rifillojnë brenda javës.	Pranohet	Është dhënë afat dhe zotim i qartë për rifillimin e punimeve.
2	Xhevdet Krasniqi Negroc dhe Vuçak	Asfaltimi i disa rrugicave gjatë vitit aktual.	Drejtori i Infrastrukturës konfirmoi se rrugicat e planifikuara do të asfaltohen gjatë këtij viti.	Pranohet	Kërkesa është konfirmuar për realizim brenda vitit.
3	Hasani Elshani Gllobar	Shtrimi i rrugës së arave dhe rrafshimi i sipërfaqes së dëmtuar pas punimeve të kanalizimit – faza II.	Kryetari deklaroi se rruga figuron në hartë dhe do të realizohet. Nuk u dha përgjigje e veçantë për rrafshimin e sipërfaqes pas kanalizimit.	Pjesërisht pranohet	Realizimi i rrugës u pranua, ndërsa kërkesa për rrafshim nuk u adresua në mënyrë të qartë.
4	Hasani Elshani Gllobar	Vendosja e ndriçimit publik pranë dy shtëpive në lagjen Elshani.	Kryetari konfirmoi se ndriçimi për dy shtëpitë do të realizohet.	Pranohet	Është dhënë zotim i drejtpërdrejtë për realizim.
5	Izet Seferi Drenas	Vazhdimi i fazës së dytë të asfaltimit të rrugës “Fehmi dhe Xhevë Lladrovci”.	Kryetari bëri të ditur se faza e dytë e rrugës pritet të fillojë së shpejti.	Pranohet	Është konfirmuar vazhdimi i projektit.



Nr.	Parashtruesi / lokaliteti	Pyetja ose kërkesa	Përgjigjja institucionale	Vlerësimi	Arsyetimi i vlerësimit
6	Izet Seferi Drenas	Shtimi i kontrolleve dhe pranisë policore për shkak të tejkalimit të shpejtësisë.	U sqarua se Policia është përgjegjëse për kontrollin dhe qytetarët u ftuan të raportojnë shkeljet.	Pjesërisht pranohet	Problemi u njoh dhe u orientua për raportim, por nuk u dha zotim për shtim të njësisve policore.
7	Izet Seferi Drenas	Sqarim dhe vazhdim i projektit për objektin e ri të QKMF-së.	Komuna është duke përgatitur dokumentacionin për iniciimin e procedurave gjyqësore ndaj ministrisë përkatëse.	Pjesërisht pranohet	Është paralajmëruar veprim juridik, por nuk është dhënë afat ose zotim për vazhdimin e ndërtimit.
8	Habib Gashi Nekoc	Sanimi dhe pastrimi i kanaleve kulluese të rrugëve.	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë deklaroi se ekipet dalin rregullisht në terren për sanimin e problemeve.	Pjesërisht pranohet	U konfirmua trajtimi në terren, por pa plan, afat ose konfirmim specifik për të gjitha kanalet.
9	Habib Gashi Nekoc	Ndërtimi i trotuarit nga lagjja Fana deri te lagjja Krapit.	U sqaruan kufizimet buxhetore dhe nevoja për përcaktimin e një prioriteti, por trotuari nuk u konfirmua veçmas për realizim.	Pjesërisht pranohet	Kërkesa u trajtua në kuadër të prioritetëve, por nuk mori zotim të plotë.
10	Habib Gashi Nekoc	Vendosja e një shtrese të re asfalti në rrugën kryesore të fshatit.	Drejtoria njoftoi se rruga e propozuar nga përfaqësuesit e fshatit është përfshirë në projektin për realizim.	Pranohet	Rruga është përfshirë në projekt dhe është konfirmuar për realizim.
11	Shpend Shala Drenas	Lirimi dhe administrimi i parkingjeve për banorët e ndërtesave kolektive.	U sqarua se çështja duhet të trajtohet përmes strukturës banesore dhe këshillit të banorëve, sipas legjislacionit.	Pjesërisht pranohet	Kërkesa nuk u pranua drejtpërdrejt, por u përcaktua mekanizmi ligjor për trajtimin e saj.
12	Shpend Shala Drenas	Shteg për biçikleta, rrethojë në oborrin e SHFMU “Rasim Kiçina” dhe vendosje e barit sintetik në fushën sportive.	Moderatori njoftoi se kërkesat janë dorëzuar më herët në formë elektronike dhe janë duke u trajtuar nga drejtoritë kompetente.	Pjesërisht pranohet	Kërkesat janë pranuar për shqyrtim, por nuk është konfirmuar realizimi i tyre.



Nr.	Parashtruesi / lokaliteti	Pyetja ose kërkesa	Përgjigjja institucionale	Vlerësimi	Arsyetimi i vlerësimit
13	Shpend Shala Drenas	Vendosja e rezervuarëve të ujit për ndërtesat kolektive.	Kryetari sqaroi se furnizimi me ujë nuk është kompetencë e drejtpërdrejtë e Komunës dhe përmendi investime alternative në pompa dhe burime ujore.	Refuzohet	Nuk u dha zotim për vendosjen e rezervuarëve; u ofruan vetëm sqarime për kompetencën dhe masa alternative.
14	Shpend Shala Krajkovë	Rregullimi i kanaleve kulluese pranë shkollës së fshatit Krajkovë.	U njoftua se kërkesa ishte dorëzuar më herët dhe ishte në trajtim nga strukturat kompetente.	Pjesërisht pranohet	Kërkesa është marrë në shqyrtim, por nuk është dhënë afat ose vendim për realizim.
15	Xhafer Dobërdolani Korroticë e Epërme	Përfundimi i kanalizimit dhe ujësjellësit, si dhe ndërtimi i rreth 900 metrave trotuar.	Kryetari deklaroi se mjetet janë të ndara dhe se realizimi kërkon zhvillimin e procedurave ligjore.	Pjesërisht pranohet	Ekziston bazë financiare dhe procedurale, por nuk u konfirmua afat ose realizim i veçantë për secilin projekt.
16	Xhafer Dobërdolani Korroticë e Epërme	Ndryshimi i mënyrës së ndarjes së pajisjeve bujqësore, me përparësi për fermerët aktivë që nuk kanë pajisje.	Kryetari sqaroi se përfituesit përcaktohen nga komisioni sipas procedurave dhe se palët kanë të drejtë ankese te komisioni i pavarur.	Refuzohet	Nuk u pranua ndryshimi i propozuar; u konfirmua vazhdimi i procedurës dhe kritereve ekzistuese.
17	Avdyl Gashi Qendra e Rinisë, Drenas	Krijimi ose funksionalizimi i një qendre rinore në Drenas.	Kryetari kërkoi që projektet e reja të paraqiten gjatë dëgjimeve buxhetore që fillojnë muajin pasues.	Pjesërisht pranohet	Kërkesa u orientua për shqyrtim buxhetor, por nuk u mor vendim për realizim.
18	Avdyl Gashi Llapushnik	Vendosja e një mbikalimi mbi autostradën "Ibrahim Rugova" në Llapushnik.	U theksua se rruga është në kompetencë të nivelit qendror dhe se kërkesat për projekte të reja duhet të trajtohen në proceset përkatëse buxhetore.	Refuzohet	Komuna nuk mori përsipër realizimin, pasi çështja është në kompetencë të nivelit qendror.
19	Kadri Ajazi, Zekë Klluna dhe Hafiz Muja Fshatrat përkatëse	Asfaltim rrugësh, ndriçim publik dhe ndërtim trotuarësh në lokalitetet që përfaqësojnë.	U sqarua se kërkesat duhet të paraqiten dhe të trajtohen gjatë dëgjimeve buxhetore.	Pjesërisht pranohet	Kërkesat u pranuan për procesin e planifikimit, por nuk u konfirmua financimi ose realizimi.



Nr.	Parashtruesi / lokaliteti	Pyetja ose kërkesa	Përgjigjja institucionale	Vlerësimi	Arsyetimi i vlerësimit
20	Arbnor Istogu Polluzhë	Vazhdimi dhe përfundimi i projekteve të mbetura, përfshirë asfaltimin e rrugëve.	Drejtori i Infrastrukturës konfirmoi se rrugët do të asfaltohen dhe projektet do të përfundojnë.	Pranohet	Është dhënë zotim i qartë për vazhdim dhe përfundim.
21	Arbnor Istogu Polluzhë	Identifikimi dhe sanimi i defektit në ndriçimin publik të përfunduar, por jashtë funksionit.	Drejtorja do ta verifikojë problemin; nëse projekti është në garanci, do të obligohet kompania, ndërsa në të kundërtën Komuna do të ndërmarrë masa.	Pranohet	Është dhënë zotim për verifikim dhe sanim, pavarësisht mënyrës së financimit të ndërhyrjes.



STATISTIKAT E PJESËMARRJES



Përmbyllja

Tubimi u shpall i mbyllur nga moderatori në orën 12:30.

Procesmbajtësi
Arton Hasani



SHTOJCAT

Nga kjo faqe e tutje paraqiten shtojcat përcjellëse të këtij procesverballi, të renditura sipas radhës në vijim:

NR.	SHTOJCA	PËRMBAJTJA
01	Ftesat dhe njoftimet publike	Materialet e publikuara për njoftimin dhe organizimin e tubimit.
02	Njoftimet në gjuhën shqipe dhe serbe	Versionet zyrtare të njoftimeve në të dyja gjuhët.
03	Lista e pjesëmarrësve	Evidenca e personave të pranishëm në tubim.
04	Fotografitë nga tubimi	Dokumentimi fotografik i zhvillimit të tubimit.

Shënim: Shtojcat paraqiten në faqet vijuese sipas renditjes së mësipërme.



FTESAT DHE NJOFTIMET PUBLIKE

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		11/06/2026	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	060/01	22404	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Në vështrim të nenit 68, Kreu i IX- Demokracia e Drejtpërdrejtë dhe Mekanizmat e Pjesëmarrjes së Qytetarëve, pika 68.1, 68.2 dhe 68.3 që ka të bëjë me informimin publik dhe konsultim të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 21, 22, 23, 24, 25 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 18 pika 1, 4, 5. 5.1, 5.2., pika 6, 7,8 dhe 9 të Rregullores Komunale për Transparencë si dhe nenit 17 të Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci:

ORGANIZON Tubim me publikun

Të eniten më datën 25.06.2026 duke filluar në orën 11:00.

Tubimi me publikun do të mbahet në **Sallën e Kuvendit** dhe ftohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara të Komunës, të marrin pjesë në këtë Tubim Publik duke ju përmbajtur terminin të caktuar më lart.

Në këtë Tubim me publikun përfaqësuesit e Komunës do të informojnë pjesëmarrësit për aktivitetin e Komunës për gjashtëmujorin e parë të këtij viti, për të arriturat, vështirësitë dhe synimet, si dhe investimet kapitale, ndërsa pjesëmarrësit mund t'u shtrojnë pyetje dhe të japin propozime përfaqësuesve të zgjedhur komunal lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara për gjashtëmujorin e parë dhe çështje tjera në interes të qytetarëve të Komunës.

Me respekt!



KRYETAR I KOMUNËS
Ramiz Lladrovci



KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		11/06/2026	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	060/01	22404	



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
 Opština Drenas – Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit



Na osnovu člana 68, Glava IX – Direktna demokratija i mehanizmi učešća građana, tačke 68.1, 68.2 i 68.3 Zakona o lokalnoj samoupravi, članova 21, 22, 23, 24 i 25 Statuta Opštine Drenas, tačke 1, 4, 5, 5.1, 5.2, 6, 7, 8 i 9 člana 18. Opštinske uredbe o transparentnosti, kao i člana 17. Administrativnog uputstva za otvorenu administraciju u opštinama, Predsednik Opštine Drenas, Ramiz Lladrovi:

ORGANIZUJE Javnu tribinu sa građanima

U **petak**, dana **25.06.2026.** godine, sa početkom u **11:00** časova.

Javna tribina će se održati u **Sali Skupštine**, a pozivaju se svi građani i zainteresovani subjekti Opštine da prisustvuju ovom javnom događaju, u skladu sa navedenim terminom.

Na ovoj javnoj tribini, predstavnici Opštine će obavestiti prisutne o aktivnostima Opštine tokom prve polovine tekuće godine, dostignućima, izazovima i ciljevima, kao i o kapitalnim investicijama. Učesnici će imati priliku da postave pitanja i iznesu predloge izabranim opštinskim predstavnicima u vezi sa sprovođenjem planiranih projekata za prvo polugodište i drugim pitanjima od interesa za građane Opštine.

Sa poštovanjem,



Predsednik Opštine
 Ramiz Lladrovi





REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
ZYRA E KRYETARIT



TUBIM ME PUBLIKUN

Zëri juaj, forca e komunës sonë!

Komuna e Drenasit ju fton të merrni pjesë në Tubimin me Publikun, një hap i rëndësishëm drejt transparencës, llogaridhënies dhe zhvillimit të përbashkët të komunës sonë.



KUSH?



Komuna e Drenasit
Fton të gjithë qytetarët, organizatat, bizneset dhe palët e interesuara të marrin pjesë.

ÇFARË?



Tubim me Publikun
Prezentim i aktiviteteve, arritjeve, sfidave dhe investimeve të komunës, si dhe diskutim i hapur me qytetarët.

KUR?



Të enjten
25 QERSHOR 2026
Duke filluar në orën
11:00

KU?



Sallën e Kuvendit
Komuna e Drenasit



PSE?



Përse është i rëndësishëm?
Për të informuar qytetarët, për të dëgjuar idetë tuaja, për të forcuar besimin dhe për të ndërtuar së bashku një komunë më të mirë për të gjithë.



**BASHKË PËR NJË KOMUNË MË TË HAPUR
DHE ME PJESËMARRJE!**



Linqet relevante:

<https://gllogoc.rks-gov.net/news/njoftimi-per-tubimin-e-pare-me-publikun/>

https://www.facebook.com/story.php?story_fbid=1526368205961100&id=100057638043139&mibextid=wwXIfr&rdid=f4aD1OjRiWZb0jbF#

https://www.facebook.com/story.php?story_fbid=1516283803636207&id=100057638043139&mibextid=wwXIfr&rdid=9yW96ztrJogiEhho#



LISTA E PJESEMARRËSVE



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas-Municipality of Drenas



Lista e pjesëmarrësve në Tubimin e parë me Publikun, datë: 25.06.2026

Nr.	Emri	Mbiemri	Gjinia M F	Nënshkrimi
1.	KADRI	AJAZI	M.	
2.	XHAFFER	DOBËRDOJANI	M.	
3.	Gentrit	Mulaku	M	
4.	Zekë Klona	Klona	M.	
5.	HABIBI IAHIRAD	TAHIRAJ	M	
6.	XHEVDET KRASHNIQI		M	
7.	ARSHEN ISTOGU	ISTOGU	M	
8.	HAFIZ MUJA	MUJA	M	
9.	IBRAHIM HASOZAJ		M	
10.	A FRIM	PROKSHI	M	
11.	Rosovare Karajli		F	
12.	Shkender Ferizi	Ferizi	M	
13.	BLERTA	BERISHA	F	
14.	ANTIGONA	BUCOLLI	F	
15.	Arbinda Klona	MURTESI	F	
16.	Devlajë	Khema	F	
17.	Andy	GASHI	M	
18.	SHKENDIJE	THAQI	F	
19.	VLORA	GRINOPCI	F	
20.	MIGJEN BEKA	SKENDRAJ	M	
21.	Abim B	BEJUPI	M	
22.	GRANIT	ELSHALLI	M	
23.	IZET	SEFETI	M	
24.	Hasan	ESHKANI	M	
25.	ABEDIN KARRAJA	KARRAJA	M	
26.	Abim HARRIB	GASHI	M	

* Në këtë takim, përveç kësaj liste, do të bëhen fotografi dhe, me nënshkrimin tuaj, pajtoheni që fotografi dhe kjo listë të përdoren për komunikim zyrtar.



27.	Ylipend	Yhaler	M	
28.	Frotim	Shala	M	
29.	Arben I'	Haruni	M	
30.	Enes Hoxha	Hoxha	M	
31.	Hexhmedin Gruda	Gruda	M	
32.	Muhamet	Gjoka	M	
33.	PETRI T	GASHI	M	
34.	ENDRI T	GLAROVA	M	
35.	Anon	Krasnigji	M	
36.	ALBAN ZOGAS	ZOGAS	M	
37.	SHUKRIE AZIZI	VEJCI	F	
38.	Valentina Sejdiu Gashi	Vatj	F	
39.	ZVONIL	MIZI	M	
40.	Bekim	Dobra	M	
41.	Arben	Shala	M	
42.	Sadete	Zeriqi	F	
43.	Altona	Mulgj' Hyduni	F	
44.	Ramir's	Kladrava!	M	
45.				
46.				
47.				
48.				
49.				
50.				
51.				
52.				
53.				
54.				
55.				
56.				
57.				
58.				
59.				
60.				
61.				
62.				

* Në këtë takim, përveç kësaj liste, do të bëhen fotografi dhe, me nënshkrimin tuaj, pajtohemi që fotografitë dhe kjo listë të përdoren për komunikim zyrtar.



FOTOGRAFI NGA TUBIMI







